

V E N D I M
Nr. 354, datë 7.7.2000

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMN NR.217, DATË 5.5.2000, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KONTROLLIN FINANCIAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.217, datë 5.5.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3.4, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Drejtori i drejtorisë së kontrollit në prefekturë emërohet nga ministri i Pushtetit Lokal, me propozimin e prefektit.”.

2. Pika 3.5 ndryshohet si vijon:

Në vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.213, datë 28.3.1998 bëhen këto shtesa:

“Në Lidhjen “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në shkronjën B1 shtohet emërtimi “Drejtor departamenti në ministri”.

Në shkronjën B3 shtohet emërtimi “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, në ministri”.

Në shkronjën B4 shtohet emërtimi “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, në prefekturë, përgjegjës sektori dhe përgjegjës i zyrës së kontrollit, në ministri”.

Në shkronjën B5 shtohet emërtimi “Inspektor i kontrollit në ministri”.

Në shkronjën C2 shtohet emërtimi “Inspektor kontrolli në drejtoritë e kontrollit, në prefektura”.

3. Në pikën 2.1.3, shprehja “Me urdhër të qeverisë“, zëvendësohet “Me urdhër të Kryeministrit”.

4. Pika 2.2.5 ndryshohet si vijon:

“Drejtoritë e kontrollit financiar në prefektura, sipas ligjit, kanë detyrë të mbulojnë, brenda vitit, me kontroll-revizioni të përgjithshëm të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për fondet e dhëna nga buxheti i shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta